



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:019240

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05697150

KPPP.nr. 102/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbaremore të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë–Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, kundër debitorit Limak Kosovo International Airoport J.S.C Sh.a., me numër të regjistrimit të biznesit 810803868, me adresë Qyteza Pejton-Mbreti Zog 1 BR.09, Prishtinë, i cili sipas autorizimit përfaqësohet nga Sh.S. dhe L.F., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr. 743/2023 të datës 21.12.2023, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Rezarta Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 16.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Limak Kosovo International Airoport J.S.C Sh.a., ndërsa Urdhri Përmbaremore P.nr. 743/2023 i datës 21.12.2023, i lejuar nga Përmbareuesi Privat Rezarta Metaj, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati i Punës në Mitrovicë– Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në bazë të dokumentit përmbareues - Vendimit Nr.01/56-183/23-Gj i datës 30.08.2023 ka caktuar zbatimin e përmbaremit përmes urdhrit përmbaremore P.nr. 743/2023 të datës 21.12.2023 ndaj debitorit Limak Kosovo International Airport J.S.C Sh.a., të cilin e ka detyruar që në emër të masës ndëshkimore të shqiptuar sipas aktvendimit të lartcekur, t'ia paguaj kreditorit shumën e borxhit prej 2,500.00 EUR (dymijë e pesëqind euro), nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare, dhe shitjen e sendeve të luajtshme pronë e debitorit, si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës përmbaremore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se e konteston urdhrin për lejimin e përmbarimit tërësisht të pa bazuar duke qenë se kreditorit ka lëshuar vendim duke u bazuar në pretendime dhe fakte tërësisht të pavërteta. Pastaj thekson edhe se urdhri për përmbarim nuk mund të ekzekutohet dhe nuk është i përmbarueshëm, pasi që kushti i përcaktuar me dokumentin përmbarues nuk është i ekzekutueshëm në pajtim me nenin 71 par.1.7 të LPP-së, duke u nisur nga ajo se debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë nda Inspektoratit të Punës, si dhe ka parashtruar padi në gjykatë ndaj këtyre vendimeve. Andaj i propozon gjykatës që ta aprovoj propozimin e debitorit dhe ta abrogoj Urdhrin Përmbarimor P.nr. 743/23 të datës 20.12.2023, si dhe të obligohet kreditori t'i bartë shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka kontestuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pa bazuar duke theksuar se kreditori propozimin për përmbarim e ka parashtruar si rezultat i mos përbushjes vullnetare të detyrimeve, dhe se pretendimet e debitorit se urdhri përmbarimor nuk mund të ekzekutohet dhe nuk është i përmbarueshëm, pasi që dokumenti përmbarues nuk është i ekzekutueshëm në pajtim me nenin 71 par.1.7 të LPP-së, nuk qëndrojnë pasi që kreditori i ka vendosur vulat e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë. Pastaj ka theksuar edhe se ushtrimi i padisë në konflikt administrativ nuk e ndalë ekzekutimin e vendimit, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzoj prapësimin e debitorit dhe ta lë në fuqi Urdhrin Përmbarimor P.nr. 743/23 të datës 21.12.2023 të lejuar nga Përmbaruesi Privat Rezarta Metaj.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Vendimin Nr.01/56-183/23-Gj të datës 30.08.2023, në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 par. 1, nën-par. 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla, dhe i cili vendim i

përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata tutje vlerëson se Vendimi Nr. 01/56-183/23-Gj i datës 30.08.2023, i plotëson kushtet e përcaktuara edhe në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmërisë për përbarueshmëri”*, ngase aktvendimi i lartcekur është i pajisur me klauzolën e përbarueshmërisë nga e cila rezulton se i njëjti është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm me datë 09.09.2023.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së dokumentit përbarues, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përbarimore, prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 102/24, datë 16.05.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.